



Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive  
Supporting Good Governance and Active Citizenry

**Republika e Kosovës**  
**Zyra e Presidencës e Republikës së Kosovës**  
znj. Atifete Jahjaga, Presidente

Prishtinë, 26/07/2012

**E nderuara Presidente Jahjaga,**

Lëvizja FOL vlerëson lartë vullnetin e shprehur nga ana Juaj për të mbështetur luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar në Kosovë. Vullneti dhe gatishmëria e Juaj për themelimin e Këshillit Kombëtar Kundër Korrupsionit është mbështetur fuqishëm në opinionin publik, duke shpresuar që agjenda anti-korrupsion e institucioneve tona të jetë serioze dhe të nxjerr rezultate konkrete.

Duke marrë parasysh nivelin e lartë të korrupsionit në Republikën e Kosovës, mungesën tejet shqetësuese të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, si dhe duke vlerësuar vullnetin e shprehur nga ana Juaj për të ndërtuar institucione të mirëfillta demokratike, Lëvizja FOL ju propozon që Republika e Kosovës të kërkojë anëtarësim në Open Government Partnership ([www.opengovpartnership.org](http://www.opengovpartnership.org)). Kjo organizatë, e themeluar në shtator të 2011, është një nismë që synon të sigurojë angazhime konkrete nga qeveritë përkatëse për të nxitur transparencën, fuqizimin e qytetarisë aktive në luftimin e korrupsionit, si dhe për të ndërtuar mirë qeverisjen e një vendi.

Në bazë të analizave, studimeve dhe raporteve të institucioneve dhe organizatave të ndryshme lokale dhe ndërkombëtare dëshmohet se mungesa dhe niveli i ultë i transparencës së institucioneve publike është njëri ndër shkaktarët e nivelit të lartë të korrupsionit në vend. Fatkeqësisht, kjo është gjendja aktuale që e pasqyron vendin tonë. Për këtë, Lëvizja FOL një pjesë të madhe të angazhimit të saj e ka kanalizuar në promovimin e transparencës së institucioneve publike.

Prandaj, duke pas parasysh nivelin e ultë të transparencës në institucionet publike, si një nga promotorët e nivelit të lartë të korrupsionit në vend, duke pas parasysh vullnetin e Juaj, përgjegjësinë kushtetuese dhe mundësinë e mirë që Kosova të fuqizojë parimet e një qeverisje demokratike e të hapur për qytetarët e saj, Lëvizja FOL kërkon nga Ju që të pranoni këtë propozim dhe të inicioni anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë. Lëvizja FOL shpreh gatishmërinë e saj për bashkëpunim dhe asistim në çdo fazë të anëtarësimit të Kosovës në këtë organizatë.

Ju faleminderit paraprakisht për konsideratën Tuaj ndaj këtij propozimi.

Me respekt,  
**Petrit Zogaj**  
Drejtore Ekzekutiv